# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2019 – Numri: 5

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E mërkurë, 23 janar 2019**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i Kuvendit nr. 19/2019, datë 21.1.2019 | Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e ministrit për Europën dhe Punët e Jashtme............................................... | 165 |
| Vendim i Kuvendit nr. 20/2019, datë 21.1.2019 | Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e Kryeministrit, zotit Edi Rama, edhe ministër për Europën dhe Punët e Jashtme............................................................................................................. | 165 |
| Dekret i Presidentit nr. 11060, datë 16.1.2019 | Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..................................................... | 165 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 14, datë 16.1.2019 | Për trajtimin financiar të anëtarëve të Bordit të Përzgjedhjes, të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe ankesat në Ministrinë e Brendshme dhe të sekretariatit teknik pranë këtij Komisioni............................................................................. | 166 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 16, datë 16.1.2019 | Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2019, në njësitë e qeverisjes qendrore..................................................... | 166 |
| Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 1, datë 9.1.2019 | Për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, viti shkollor 2018–2019............................................................................................... | 171 |
| | Bibliografia e Informacionit të Deklasifikuar në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), datë 16.1.2019........ | 172 |
| | Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Eduart Kamberaj........... | 174 |

**VENDIM**
**Nr. 19/2019**

## PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIMIN E MINISTRIT PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Në mbështetje të nenit 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr. 11061, datë 18.1.2019, të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr. 11061, datë 18.1.2019, për shkarkimin e zotit Ditmir Bushati nga detyra e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 21.1.2019.

**VENDIM**
**Nr. 20/2019**

## PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E KRYEMINISTRIT, ZOTIT EDI RAMA, EDHE MINISTËR PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Në mbështetje të nenit 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr. 10 062, datë 18.1.2019, të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr. 10062, datë 9.1.2019, për emërimin e Kryeministrit, zotit Edi Rama, edhe në detyrën e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 21.1.2019.

**DEKRET**
**Nr. 11060, datë 16.1.2019**

## PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Mirtan Zyhdi Zotaj
2. Berwin Mirtan Zotaj
3. Fjoralda Nikoll Prengaj
4. Lefterie Xhemal Adili (Neli)
5. Gert Jakup Harka
6. Skender Adem Hasa
7. Adela Artan Belitz (Gjollesha)
8. Ermal Fatmir Alhasa
9. Mimoza Fiqiri Hoock (Reçi)
10. Fatjon Abas Ndregjoni
11. Elda Agim Vladi (Ademi)
12. Mark Lenin Vladi
13. Arindi Besnik Qoshja
14. Etleva Shefit Osmani (Beqiri)
15. Vjola Shkëlqim Rakipllari
16. Bato Ilir Leka
17. Erald Byrhan Vuçini
18. Hana Prekë Mernaçaj (Ulaj)
19. Marjola Fatmir Muçaj (Hamitaj)
20. Mesilda Medi Stafa
21. Rovena Sami Qerozi (Abazi)
22. Muhammed Emin Arif Qerozi
23. Edisa Arif Qerozi
24. Dilara Arif Qerozi
25. Artur Zydi Tato

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
**Ilir Meta**

**VENDIM**
**Nr. 14, datë 16.1.2019**

## PËR TRAJTIMIN FINANCIAR TË ANËTARËVE TË BORDIT TË PËRZGJEDHJES, TË KOMISIONIT TË JASHTËM TË VLERËSIMIT KALIMTAR TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, TË GARDËS SË REPUBLIKËS DHE TË SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT NË MINISTRINË E BRENDSHME DHE TË SEKRETARIATIT TEKNIK PRANË KËTIJ KOMISIONI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të pikës 2, të nenit 29, të ligjit nr. 12/2018, "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme", dhe të nenit 13, të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e trajtimit financiar për disa nga organet e vlerësimit të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe të Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme, të cilat janë:

a) Bordi i Përzgjedhjes së Anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit;

b) Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit;

c) Sekretariati teknik pranë Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.

2. Shpërblimi për anëtarët e Bordit të Përzgjedhjes të jetë në masën 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, i cili jepet pas përfundimit të procedurës së përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe të anëtarëve të sekretariatit teknik përkatës.

3. Paga për anëtarët e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit të jetë në masën 190 000 (njëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë në muaj.

4. Paga për anëtarët e sekretariatit teknik të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit të jetë në masën 110 000 (njëqind e dhjetë mijë) lekë në muaj.

5. Për mbulimin e efekteve financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në buxhetin e Ministrisë së Brendshme miratuar për vitin 2019 shtohet fondi në vlerën 42 000 000 (dyzet e dy milionë) lekë, të cilat përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

6. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

**VENDIM**

**Nr. 16, datë 16.1.2019**

## PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2019, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2019, në njësitë e qeverisjes qendrore është 1 335 (një mijë e treqind e tridhjetë e pesë), sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Për 1 (një) inspektor në ILDKP, për 28 (njëzet e tetë) specialistë të aparatit të Kryeministrisë, për 4 (katër) specialistë të sekretariatit teknik të Komisionit të Dhënies së Dëshmisë të Statusit të Naftëtarit, për 1 (një) specialist të aparatit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për 3 (tre) specialistë të Departamentit të Administratës Publike, për 5 (pesë) specialistë të Drejtorisë së Dëmshpërblimit të ish- të Përndjekurve Politikë dhe 1 (një)

punonjës protokoll-arkivi në aparatin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të përfshirë në lidhjen nr. 1, të sipërpërmendur, nuk zbatohet pika 3, e vendimit nr. 1703, datë 24.12.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme për ministritë dhe institucionet buxhetore".

3. Pagesa për emërtesën "Punonjës arkivi (DPA)", e përfshirë në lidhjen nr. 1, të sipërpërmendur, kryhet nga institucionet përkatëse, pas miratimit të listëprezencës dhe shënimeve përkatëse të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Ngarkohet DPA-ja të miratojë rregullat për përpunimin e fondit arkivor të mbartur dhe të njoftojë për këto rregulla punëdhënësit dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, brenda një muaji, pas miratimit të vendimit.

4. Punonjësit me kontratë në funksionin "specialist" paguhen në përputhje me kategorinë e pagës së funksionit të ngjashëm organik, të përcaktuar në strukturën e institucionit, por, në asnjë rast, kategoria e pagës së tyre në institucionet e pavarura dhe aparatet e ministrive nuk kalon nivelin IV-a dhe, në institucionet në varësi të institucioneve qendrore, nivelin IV-b. Përjashtim bëjnë specialistët e aparatit të Kryeministrisë, të cilët paguhen në kategorinë e pagës të nivelit III-b.

5. Për pranimet e reja të punonjësve me kontratë në funksionet "specialist", që nuk plotësohen me punonjës, të cilët kanë lidhur kontratë në vitin paraardhës dhe puna e të cilëve është e pandërprerë, zbatohen dispozitat e vendimit nr. 812, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, jashtë shërbimit civil, për vitin 2019".

6. Mbulimi i efekteve financiare për punonjësit me kontratë bëhet nga shpenzimet korrente, të miratuara në buxhetin përkatës të vitit 2019 të njësive të qeverisjes qendrore. Për punonjësit me kontratë të Shtëpisë së Pushimit Durrës (MB), të Shtëpisë së Pushimit të SHISH-it dhe të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, efektet financiare përballohen nga të ardhurat e vetë institucionit.

7. Ngarkohen ministritë dhe institucionet sipas lidhjes nr. 1, të përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë detajimin e numrit të punonjësve me kontratë, kategorinë përkatëse të pagës dhe burimin e financimit të tyre.

8. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi fillojnë pas hyrjes në fuqi të tij. Për punonjësit, të cilët kanë lidhur kontratë në vitin paraardhës, puna e të cilëve nuk është ndërprerë dhe për të cilët është bërë regjistrimi në sistemin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, efektet financiare fillojnë më 1 janar 2019.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

**Lidhja nr. 1**

| Gr. | Emri i institucionit | | Emërtesa | Koha mesatare ditore | Periudha kohore |
|---|---|---|---|---|---|
| 02 | **Kuvendi** | **10** | | | |
| | Shërbimi i Botimeve Parlamentare | 3 | Specialist redaktimi | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Shërbimi i marrëdhënieve me publikun | 1 | Specialist për mediat | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Sektori i Arkivit të Dokumentacionit Parlamentar | 1 | Punonjës protokoll arkiv | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Drejtoria e Shërbimi Mirëmbajtjes | 2 | Punonjës mirëmbajtjeje | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Drejtoria e Shërbimi Mirëmbajtjes | 3 | Teknikë të mesëm | 6 orë/ditë | 6-mujore |
| 3 | **Kryeministria** | **57** | | | |
| | Aparati | 28 | Specialist | 8 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati | 29 | Operator | 6 orë/ditë | vjetore |
| 05 | **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural** | **23** | | | |
| | Aparati i Ministrisë | 1 | Punonjës pastrimi | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 1 | Nëpunës informacioni | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 5 | Punonjës arkivi (DPA) | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 4 | Punonjës arkivi | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 1 | Operator për EDRMS | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës | 4 | Teknik i mesëm | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës | 1 | Drejtues motobarke | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës | 6 | Punëtorë mirëmbajtjeje | 6 orë/ditë | vjetore |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **6** | **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë** | **34** | | | |
| | Aparati i Ministrisë | 5 | Nëpunës informacioni | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 1 | Teknik i mesëm | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 4 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 1 | Punonjës protokolli | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 5 | Punonjës arkivi (DPA) | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 4 | Specialist në sekretariatin e NAFTËS | 8 orë/ditë | vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Mbetjeve | 1 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit | 1 | Punonjës arkivi | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Instituti i Transportit | 1 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor | 1 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Drejtoria e Përgjithshme Detare | 1 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Agjencia për Eficencën e Energjisë | **1** | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Autoriteti për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera | 1 | Teknik i mesëm | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial | 2 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial | 1 | Punonjës mirëmbajtjeje | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar | 4 | Teknikë të specialiteteve të ndryshme | 6 orë/ditë | vjetore |
| **10** | **Ministria e Financave dhe Ekonomisë** | **362** | | | |
| | Aparati i Ministrisë (Drejtoria e Drejtimit të Pronës) | 1 | Punonjës protokoll/arkivi | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 5 | Punonjës arkivi (DPA) | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 1 | Punonjës protokoll/arkivi | 8 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 2 | Nëpunës informacioni | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 7 | Specialist | 8 orë/ditë | 6-mujore |
| | Aparati i Ministrisë | 3 | Specialist arkivi | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 4 | Mirëmbajtës/sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 1 | Teknik i mesëm | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 1 | Fotokopjues | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshpërblimeve | 5 | Specialist | 8 orë/ditë | vjetore |
| | Degët e Thesarit | 24 | Sanitar | 4 orë/ditë | vjetore |
| | Degët e Thesarit Vlore | 1 | Sanitar | 3 orë/ditë | vjetore |
| | Dega e Thesarit Lushnje | 1 | Sanitar | 2 orë/ditë | vjetore |
| | Dega e Thesarit Durrës | 1 | Sanitar | 5 orë/ditë | vjetore |
| | Dega e Thesarit Tiranë | 1 | Nëpunës informacioni | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Dega e Thesarit Tiranë | 2 | Punonjës arkivi | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Dega e Thesarit Skrapar | 3 | Specialist | 8 orë/ditë | 6-mujore |
| | Agjencia e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve | 1 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Agjencia e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve | 1 | Punonjës mirëmbajtjeje | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve | 1 | Punonjës mirëmbajtjeje | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Drejtoria e P. Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore | 250 | Punonjës shërbimi | 8 orë/ditë | 6-mujore |
| | Drejtoria e P. Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore | 23 | Arkivist/protokollist | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Drejtoria e P. Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore | 6 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Agjencia e Administrimit të Pasurive Sekuestruara dhe Konfiskuara | 1 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Qendra Kombëtare e Biznesit | 1 | Punonjës arkivi/protokolli | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Qendra Kombëtare e Biznesit | 1 | Teknik i mesëm | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Qendra Kombëtare e Biznesit | 1 | Nëpunës informacioni | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Qendra Kombëtare e Biznesit | 2 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë | 4 | Specialist | 8 orë/ditë | 6-mujore |
| | Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve | 1 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë | 4 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë | 1 | Lulishtar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit | 1 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| **12** | **Ministria e Kulturës** | **38** | | | |
| | Aparati i Ministrisë | 1 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 1 | Teknik i mesëm | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 1 | Operator EDRMS | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Galeria Kombëtare e Arteve | 2 | Vëzhgues/ciceron | 4 orë/ditë | vjetore |
| | Muzeu Historik Kombëtar | 2 | Teknik i mesëm | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Muzeu Historik Kombëtar | 2 | Punonjës mirëmbajtjeje | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Muzeu Historik Kombëtar | 2 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Biblioteka Kombëtare | 1 | Teknik i mesëm | 6 orë/ditë | 10 muaj |
| | Zyra e parkut Arkeologjik Butrint | 3 | Punëtor mirëmbajtjeje | 8 orë/ditë | maj–tetor |
| | ZAK Parku Arkeologjik Apoloni | 2 | Vëzhgues (ciceron/guida) | 6 orë/ditë | 8 muaj |
| | ZAK Parku Arkeologjik Apoloni | 1 | Sanitar | 4 orë/ditë | vjetore |
| | ZAK Parku Arkeologjik Bylis | 1 | Punëtor mirëmbajtjeje | 6 orë/ditë | 8 muaj |
| | Muzeu i Artit Mesjetar, Arsimit dhe Arkeologjik Korçë | 1 | Biletashitës | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Gjirokastër | 2 | Punëtor mirëmbajtjeje | 6 orë/ditë | prill–nëntor |
| | Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Gjirokastër | 1 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Gjirokastër | 1 | Biletashitës | 6 orë/ditë | prill–nëntor |
| | Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Durrës | 2 | Punëtor mirëmbajtje | 6 orë/ditë | prill–shtator |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Shkodër | 1 | Sanitare | 4 orë/ditë | vjetore |
| | Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Vlorë | 1 | Punonjës mirëmbajtjeje | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Berat | 2 | Punonjës mirëmbajtjeje | 6 orë/ditë | maj-shtator |
| | Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Berat | 1 | Vëzhgues (ciceron/guida) | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Muzeu Kombëtar Gjethi | 2 | Vëzhgues (ciceron/guida) | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Muzeu Kombëtar Gjethi | 1 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | AQSHF | 1 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | AQSHF | 1 | Restaurator | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Cirku Kombëtar | 1 | Sanitar | 6 orë/ditë | 10 muaj |
| | Qendra e Muzeumeve Berat | 1 | Vëzhgues | 4 orë/ditë | 6 muaj |
| **13** | **Ministria Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** | **52** | | | |
| | Aparati i Ministrisë | 6 | Operator | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 3 | Punonjës arkivi | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Shërbimi Kombëtar i Urgjencës | 4 | Operator | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Spitali Psikiatrik Elbasan | 3 | Kaldaist | 6 orë/ditë | janar–mars<br>nëntor–dhjetor |
| | Qendra Kombëtare Mirërritjes, Zhvillimit Fëmijëve | 2 | Mjek | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Shtëpia e të Moshuarve Tiranë | 1 | Mjek i përgjithshëm | 4 orë/ditë | vjetore |
| | Shtëpia e të Moshuarve Tiranë | 1 | Sanitar | 4 orë/ditë | vjetore |
| | Shtëpia e të Moshuarve Tiranë | 5 | Kujdestar | 4 orë/ditë | vjetore |
| | Shtëpia e të Moshuarve Tiranë | 1 | Ndihmëskuzhinier | 4 orë/ditë | vjetore |
| | Shtëpia e të Moshuarve Shkodër | 1 | Mjek i përgjithshëm | 4 orë/ditë | vjetore |
| | Shtëpia e të Moshuarve Shkodër | 1 | Sanitar | 4 orë/ditë | vjetore |
| | Shtëpia e të Moshuarve Shkodër | 1 | Ndihmëskuzhinier | 4 orë/ditë | vjetore |
| | Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë | 1 | Sanitar | 4 orë/ditë | vjetore |
| | Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë | 1 | Kujdestar | 4 orë/ditë | vjetore |
| | Qendra e Zhvillimit Tiranë | 1 | Mjek | 4 orë/ditë | vjetore |
| | Qendra e Zhvillimit Tiranë | 1 | Sanitar | 4 orë/ditë | vjetore |
| | Qendra e Zhvillimit Tiranë | 1 | Ndihmëskuzhinier | 4 orë/ditë | vjetore |
| | Qendra e Zhvillimit Durrës | 1 | Mjek | 4 orë/ditë | vjetore |
| | Qendra e Zhvillimit Durrës | 2 | Kujdestar | 4 orë/ditë | vjetore |
| | Qendra e Zhvillimit Durrës | 1 | Sanitar | 4 orë/ditë | vjetore |
| | Qendra Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje | 1 | Sanitar | 4 orë/ditë | vjetore |
| | Qendra Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje | 1 | Psikolog | 4 orë/ditë | vjetore |
| | Qendra Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje | 2 | Kujdestar | 4 orë/ditë | vjetore |
| | Qendra Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje | 1 | Punonjës social | 4 orë/ditë | vjetore |
| | Drejtoria e Përgjithshme e SHSSH-së | 1 | Punonjës mirëmbajtje | 4 orë/ditë | vjetore |
| | Drejtoria e Përgjithshme e SHSSH-së | 6 | Operator | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Drejtoria e Përgjithshme e SHSSH-së | 1 | Nëpunës informacioni | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Drejtoria e Përgjithshme e SHSSH-së | 1 | Punonjës arkivi | 6 orë/ditë | vjetore |
| **14** | **Ministria e Drejtësisë** | **499** | | | |
| | Aparati i Ministrisë | 1 | Operatorë | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 2 | Punonjës arkivi | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 2 | Nëpunës informacioni | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor | 2 | Arkivist | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Instituti i Mjekësisë Ligjore | 2 | Laborantë/ndihmësprozektor | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor | 1 | Punonjës mirëmbajtje | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor | 1 | Nëpunës informacioni | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Shërbimi për Çështjet e Birësimeve | 1 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Shërbimi për Çështjet e Birësimeve | 1 | Nëpunës Informacioni | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Qendra e Botimeve Zyrtare | 20 | Operator | 8 orë/ditë | 1 muaj |
| | ALUIZNI | 398 | Specialistë | 8 orë/ditë | vjetore |
| | ALUIZNI | 54 | Teknikë të mesëm | 8 orë/ditë | vjetore |
| | ALUIZNI | 14 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| **15** | **Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme** | **23** | | | |
| | Aparati i Ministrisë | 5 | Preparatorë | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 3 | Punonjës protokoll/arkiv | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 1 | Postier | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 1 | Lulishtar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 1 | Elektricist | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 2 | Punonjës ngarkim-shkarkimi | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 2 | Punonjës mirëmbajtje | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 1 | Nëpunës informacioni | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 4 | Punonjës pastrimi | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 1 | Specialist | 8 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 2 | Operatore EDRMS | 6 orë/ditë | vjetore |
| **16** | **Ministria e Brendshme** | **120** | | | |
| | Shtëpia e Pushimit Durrës | 6 | Kuzhinier | 8 orë/ditë | 01.6.2019-10.09.2019 |
| | Shtëpia e Pushimit Durrës | 4 | Ndihmëskuzhinier | 8 orë/ditë | 6 muaj |
| | Shtëpia e Pushimit Durrës | 30 | Kamerier | 8 orë/ditë | 01.6.2019-10.09.2019 |
| | Shtëpia e Pushimit Durrës | 18 | Punëtor Restoranti | 8 orë/ditë | 01.6.2019-10.09.2019 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Shtëpia e Pushimit Durrës | 2 | Teknik | 8 orë/ditë | 6 muaj |
| | Shtëpia e Pushimit Durrës | 6 | Recepsionist | 8 orë/ditë | 01.6.2019-10.09.2019 |
| | Shtëpia e Pushimit Durrës | 12 | Punëtor gjelbërimi | 8 orë/ditë | 01.6.2019-10.09.2019 |
| | Shtëpia e Pushimit Durrës | 10 | Punëtor kuzhine | 8 orë/ditë | 01.6.2019-10.09.2019 |
| | Shtëpia e Pushimit Durrës | 25 | Punëtor hoteli | 8 orë/ditë | 01.6.2019-10.09.2019 |
| | Shtëpia e Pushimit Durrës | 1 | Elektricist | 8 orë/ditë | 6 muaj |
| | Shtëpia e Pushimit Durrës | 1 | Hidraulik | 8 orë/ditë | 6 muaj |
| | Shtëpia e Pushimit Durrës | 3 | Lavanteri | 8 orë/ditë | 01.6.2019-10.09.2019 |
| | Prefekti i Qarkut Tiranë | 2 | Arkivist | 6 orë /ditë | vjetore |
| **17** | **Ministria e Mbrojtjes** | **1** | | | |
| | Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve | 1 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| **18** | **Shërbimi Informativ Shtetëror** | **24** | | | |
| | SHISH (shtëpitë e pushimit) | 6 | Kuzhinier | 8 orë/ditë | 15 qershor-15 shtator |
| | SHISH (shtëpitë e pushimit) | 2 | Banakier | 8 orë/ditë | 15 qershor-15 shtator |
| | SHISH(shtëpitë e pushimit) | 12 | Sanitar | 8 orë/ditë | 15 qershor-15 shtator |
| | SHISH | 4 | Sanitar | 4 orë/ditë | vjetore |
| **20** | **Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave** | **15** | | | |
| | Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave | 1 | Specialist | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave | 14 | Punonjës protokoll/arkivi | 6 orë/ditë | vjetore |
| **26** | **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit** | **8** | | | |
| | Aparati i Ministrisë | **1** | Operator për EDRMS | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 1 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Turizmit | 1 | Nëpunës informacioni | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Turizmit | 1 | Punonjës mirëmbajtjeje | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Turizmit | 1 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Mjedisit | 1 | Operator | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Mjedisit | 1 | Nëpunës informacioni | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Bregdetit | 1 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| **31** | **Agjencia Telegrafike Shqiptare** | **10** | | | |
| | Agjencia Telegrafike Shqiptare | 6 | Specialist-gazetar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Agjencia Telegrafike Shqiptare | 3 | Specialist-përkthyes | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Agjencia Telegrafike Shqiptare | 1 | Teknik | 6 orë/ditë | vjetore |
| **57** | **Qendra Kombëtare e Kinematografisë** | **1** | | | |
| | Qendra Kombëtare e Kinematografisë | 1 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| **63** | **Kolegji i Posaçëm i Apelimit** | **2** | | | |
| | Kolegji i Posaçëm i Apelimit | 1 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Kolegji i Posaçëm i Apelimit | 1 | Punëtor mirëmbajtjeje | 6 orë/ditë | vjetore |
| **66** | **Avokati i Popullit** | **7** | | | |
| | Avokati i Popullit | 7 | Specialist | 6 orë/ditë | vjetore |
| **67** | **Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil** | **4** | | | |
| | Komisioneri | 1 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Komisioneri | 2 | Operator | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Komisioneri | 1 | Punonjës arkivi | 6 orë/ditë | vjetore |
| **76** | **Inspektorati i Lartë i Deklarimit e Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave** | **1** | | | |
| | Aparati i ILDKPKI-së | 1 | Inspektor | 8 orë / ditë | vjetore |
| **77** | **Autoriteti i Konkurrencës** | **4** | | | |
| | Autoriteti i Konkurrencës | 2 | Punonjës protokoll/arkiv | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Autoriteti i Konkurrencës | 1 | Punonjës mirëmbajtjeje | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Autoriteti i Konkurrencës | 1 | Teknik i mesëm | 6 orë/ditë | vjetore |
| 87 | **Institucione të tjera qeveritare** | **21** | | | |
| | Agjencia e Prokurimit Publik | 6 | Punonjës arkivi (DPA) | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Agjencia e Prokurimit Publik | 2 | Punonjës protokoll/arkivi | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore | 1 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Departamenti Administratës Publike | 1 | Nëpunës informacioni | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Departamenti Administratës Publike | 1 | Punonjës mirëmbajtje | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Departamenti Administratës Publike | 3 | Specialist | 8 orë/ditë | vjetore |
| | Avokatura e Shtetit | 1 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Avokatura e Shtetit | 1 | Teknik i Mesëm | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Avokatura e Shtetit | 1 | Nëpunës Informacioni | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Avokatura e Shtetit | 1 | Punonjës protokoll/arkiv | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Avokatura e Shtetit | 1 | Operator | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje | 2 | Specialistë | 6 orë/ditë | vjetore |
| **88** | **Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile** | **2** | | | |
| | Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile | 1 | Specialist | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile | 1 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| **89** | **Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale** | **6** | | | |
| | Komisioneri | 1 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Komisioneri | 1 | Teknik i mesëm | 6 orë/ditë | vjetore |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Komisioneri | 2 | Operatorë | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Komisioneri | 1 | Nëpunës informacioni | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Komisioneri | 1 | Punonjës protokoll/arkivi | 6 orë/ditë | vjetore |
| **90** | **Komisioni i Prokurimit Publik** | **2** | | | |
| | Komisioni i Prokurimit Publik | 1 | Punonjës protokoll/arkivi | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Komisioni i Prokurimit Publik | 1 | Teknikë të mesëm | 6 orë/ditë | vjetore |
| **95** | **Autoriteti Informimit Dok. Ish-Sigurimit të Shtetit** | **9** | | | |
| | Aparati institucionit | 1 | Sanitar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati institucionit | 3 | Operator | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati institucionit | 1 | Bibliotekar | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati institucionit | 3 | Punonjës arkivi | 6 orë/ditë | vjetore |
| | Aparati institucionit | 1 | Teknik i mesëm | 6 orë/ditë | vjetore |
| | **TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË** | **1,335** | | | |

## UDHËZIM
## Nr. 1, datë 9.1.2019

## PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË, VITI SHKOLLOR 2018–2019

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 26 dhe 50, të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të vendimit nr. 1013, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore", të ndryshuar, dhe vendimit nr. 67, datë 10.2.2013 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Institutit të Zhvillimit të Arsimit",

UDHËZOJ:

1. Provimet kombëtare të arsimit bazë, për vitin shkollor 2018–2019, do të zhvillohen si më poshtë:

a) Lënda Gjuhë e huaj, më 10 qershor 2019;
b) Lënda Gjuhë shqipe, më 18 qershor 2019;
c) Lënda Matematikë, më 21 qershor 2019.

2. Nxënësit e pakicave kombëtare zhvillojnë edhe provimin kombëtar të arsimit bazë në lëndën Gjuhë amtare. Provimi kombëtar i arsimit bazë në lëndën Gjuhë amtare, do të zhvillohet më 14 qershor 2019.

3. Lista e gjuhëve të huaja, që do të jepen si provim i detyruar, janë: anglisht, italisht, frëngjisht dhe gjermanisht. Testi i gjuhës/ve të huaj/a hartohet në përputhje me gjuhën, e cila, në planin mësimor të arsimit të mesëm të ulët, trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar në nivelin gjuhësor A2.

4. Nxënësit e klasave të 9-ta të seksioneve dygjuhëshe italiane, gjermane dhe franceze japin provim gjuhën përkatëse të seksionit në nivelin gjuhësor A2.

5. Provimet kombëtare të arsimit bazë fillojnë në orën 10:00 dhe zgjasin 2 orë e 30 minuta.

6. Procedurat e hartimit dhe të vlerësimit të testeve përcaktohen në rregulloren për "Procedurat e organizimit dhe të zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë, viti shkollor 2018–2019".

7. Për shkollat e pakicës kombëtare greke, teza për provimin në lëndën Gjuhë amtare, përgatitet nga institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar Gjirokastër. Në ditën e provimit, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar Delvinë dhe Sarandë, tërheqin tezën në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar Gjirokastër.

8. Për shkollat e pakicës kombëtare maqedonase teza për provimin në lëndën Gjuhë amtare përgatitet nga institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar Korçë dhe tërhiqet ditën e provimit nga drejtori i shkollës, shoqëruar nga përfaqësuesi i institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar Korçë.

9. Nxënësit me aftësi të kufizuara zhvillojnë provimet kombëtare në përshtatje me veçoritë e tyre.

10. Për Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë "Ramazan Kabashi", drejtoria e këtij instituti tërheq testin nga QSHA-ja një ditë para zhvillimit të provimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit *brail*.

11. Nxënësi mbetës në provimet kombëtare të arsimit bazë, ka të drejtën e riprovimit në sesionin e dytë.

12. Institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar monitoron

procesin e provimeve kombëtare të arsimit bazë dhe raporton për çdo parregullsi të vërejtur në zhvillimin e tyre.

13. Arkivimi i testeve të bëhet pranë institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

14. Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës i institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, merr nga Qendrat e Vlerësimit të Testeve dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të jashtëm dhe të mjediseve ku janë realizuar provimet kombëtare të arsimit bazë. Këto të dhëna dërgohen në QSHA, institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar dhe MASR.

15. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
**Lindita Nikolla**

## BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË DREJTORINË E SIGURIMIT TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR (DSIK)

Datë 17.1.2019

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar 'Sekret shtetëror'", i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017, "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror'" dhe udhëzimin e drejtorit të DSIK-së, nr. 99, datë 13.4.2018 "Për zbatimin e vendimit nr. 662, datë 15.11.2017 'Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror'"", Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "Sekret shtetëror" (KDZH) në DSIK ka deklasifikuar informacionet e klasifikuara "Sekret shtetëror", si më poshtë:

**a) Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:**

1. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 11597, datë 27.10.2017, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Adnand Çerçiz Kosova", niveli "Sekret".

2. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 12328, datë 2.11.2017, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Petrit Telo Çano", niveli "Sekret".

3. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 9221, datë 18.9.2018, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Artur Skënder Selmani", niveli "Sekret".

4. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 11565, datë 27.10.2017, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Emona Shpëtim Muçi", niveli "Sekret".

5. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 11620, datë 27.10.2017, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Roland Muhedin Jaupaj", niveli "Sekret".

6. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 12372, datë 2.11.2017, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Anton Lazer Martini", niveli "Sekret".

7. Raportin e Grupit të Punës në DSIK nr. 12424, datë 02.11.2017 "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Artan Sulejman Madani", niveli "Sekret".

8. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 11850, datë 31.10.2017, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Sonila Shkëlzen Muhametaj", niveli "Sekret".

9. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 11615, datë 27.10.2017, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Gentian Shpëtim Jahjolli", niveli "Sekret".

10. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 12504, datë 2.11.2017, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Alfred Bashkim Agolli", niveli "Sekret".

11. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 12370, datë 2.11.2017, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Njazi Ramazan Seferi, niveli "Sekret".

12. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 12053, datë 2.11.2017, "Mbi kontrollin e figurës

të subjektit të rivlerësimit Artor Luftim Ylli", niveli "Sekret".

13. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 11405, datë 26.10.2017, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Fiona Theodhor Papajorgji", niveli "Sekret".

14. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 11874, datë 31.10.2017, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Artur Sadik Kalaja", niveli "Sekret".

15. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 12241, datë 2.11.2017, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Hajrie Merxhan Muçmata", niveli "Sekret".

16. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 11742, datë 30.10.2017, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Vladimir Ramiz Mara", niveli "Sekret".

17. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 11887, datë 31.10.2017, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Saida Lumner Dollani", niveli "Sekret".

18. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 11609, datë 27.10.2017, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Eriol Ilir Roshi", niveli "Sekret".

19. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 11712, datë 30.10.2017, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Brunilda Lumturi Malo (Orhani)", niveli "Sekret".

20. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 12011, datë 2.11.2017, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Idriz Shaban Mulkurti", niveli "Sekret".

21. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 11861, datë 31.10.2017, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Arben Sabri Qosja", niveli "Sekret".

22. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 11854, datë 31.10.2017, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Besim Isa Hajdarmataj", niveli "Sekret".

23. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 11558, datë 27.10.2017, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Dhimitër Aleksandër Lara", niveli "Sekret".

24. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 11799, datë 31.10.2017, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Gurali Mitat Brahimllari", niveli "Sekret".

25. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 11788, datë 31.10.2017, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Albana Burhan Boksi", niveli "Sekret".

26. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 12321, datë 2.11.2017, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Rexhep Hasan Bekteshi", niveli "Sekret".

27. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 11870, datë 31.10.2017, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Enkeledi Enver Hajro", niveli "Sekret".

28. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 12041, datë 2.11.2017, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Enkeleda Spiro Millonai", niveli "Sekret".

**b) Deklasifikoi pjesërisht informacionet e mëposhtme:**

1. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 9218, datë 18.9.2018, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Luan Mehmet Dervishi", niveli "Sekret".

2. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 7735, datë 24.7.2018, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Alltun Kajtaz Çela", niveli "Sekret".

3. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 9289, datë 20.9.2018, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Agron Sabahedin Vavla", niveli "Sekret".

4. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 9404, datë 25.9.2018, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Simon Dedë Pashuku", niveli "Sekret".

5. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 10490, datë 15.10.2018, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Artan Ibrahim Çupi", niveli "Sekret".

6. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 11034, datë 25.10.2018, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Enton Jorgji Dhimitri", niveli "Sekret".

7. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 10705, datë 18.10.2018, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Ardian Gjergj Nezha", niveli "Sekret".

8. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 10955, datë 23.10.2018, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Alfred Nezir Gjoni", niveli "Sekret".

9. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 11129, datë 29.10.2018, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Admir Arif Belishta", niveli "Sekret".

10. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 12513, datë 2.11.2017, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Adriatik Xhemal Llalla", niveli "Sekret".

11. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 10910, datë 23.10.2018, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Edison Xhemal Ademi", niveli "Sekret".

12. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 11711, datë 9.11.2018, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Izet Alai Kadana", niveli "Sekret".

13. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 11776, datë 9.11.2018, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Enton Jorgji Dhimitri", niveli "Sekret".

14. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 12129, datë 2.11.2017, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Besnik Babaçe Imeraj", niveli "Sekret".

15. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 11918, datë 14.11.2018, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Shpëtim Murat Kurti", niveli "Sekret".

16. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 11910, datë 13.11.2018, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Hajrie Merxhan Muçmata (Mata)", niveli "Sekret".

17. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 12544, datë 2.11.2018, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Ana Naun Golloshi", niveli "Sekret".

18. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 12650, datë 11.12.2018, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Fatmir Myslim Lushi", niveli "Sekret".

19. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 12551, datë 2.11.2017, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Përparim Lefter Kulluri", niveli "Sekret".

20. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 12646, datë 7.12.2018, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Anita Bujar Mici", niveli "Sekret".

21. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 12554, datë 2.11.2017, dhe nr. 12601, datë 05.12.2018 "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Alaudin Hasan Malaj", niveli "Sekret".

22. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 12775, datë 18.12.2018, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Enrik Sulo Haxhiraj", niveli "Sekret".

23. Raportin e Grupit të Punës në DSIK, nr. 12776, datë 18.12.2018, "Mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Admir Arif Belishta", niveli "Sekret".

**c) Publikimi i Bibliografisë të bëhet në Fletoren Zyrtare dhe në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK).**

DREJTORI
**Dorian Tola**

**KËRKESË**

Shtetasi Armand Kamberaj, i datëlindjes 2.2.1988, kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen të zhdukur të të atit, shtetasit Eduart Kamberaj, i datëlindjes 15.11.1965, nga data 16.1.1999, si dhe caktimin e tij në cilësinë e kujdestarit të pasurisë së të atit.

KËRKUES
**Armand Kamberaj**

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë